



Nr. 2898 Rep.

Nr. 1499 Kol.



KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Sot me date **06/12/2019 (dymije e nentembdhjete)**, para meje noteres Marsela V. Veseli, anetare e Dhomes Kombetare te Noterise, Dega Vendore Tirane, me zyre ne adresen Blv. "Gjergj Fishta", pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, u paraqiten personalisht palet e meposhtme per redaktimin e kesaj kontrate si me poshte vijon:

SHITESI: ERGYS KARINA atesia Izet, i datelindjes 11/08/199, lindur ne Peqin, Elbasan dhe banues ne Peqin, mbajtes i leternjoftimit Nr. 031430064, me numer personal J20811009B, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar dhe IRDI KARINA, atesia Izet, i datelindjes 27.01.1994, lindur ne Peqin dhe banues ne Peqin, me numer personal J40127023F, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar te dy ne cilesine e ortakeve te **SHOQERISE "IRDI & ERGYS" sh.p.k.**, e regjistruar prane QKB me date 05/03/2018, e pajisur me NIPT L81505036P, me seli ne Tirane Njesia Bashkiake nr.5, Rruga Pjeter Bogdani.

BLERESI: Z. ILIR ZYFERI, atesia Tomor, lindur me 25/04/1975, ne Durres dhe banues ne Durres, Rruga"Egnatia" i identifikuar prej meje nepermjet pasaportes Nr. BG3758848, me Nr. Personal H50425086A, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me Shtetesi Shqiptare, gjendja civile i Martuar.

Unë noterja, pasi u njoha me Ekstraktin e Shoqërise më rezultoi se shoqëria është regjistruar si shoqëri tregtare sipas ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, I ndryshuar me date 05/03/2018.

Kapitali themeltar i kësaj shoqërie është 500 000 (peseqind mije)Lekë.
Numri i pergjithshem i kuotave 2

Shoqëria "Irdi &Ergys" Sh.p.k zotërohet nga dy ortak:

- Irdi Karina i cili zotëron 1 kuote qe perben 50% të kapitalit
- Ergys Karina i cili zotëron 1 kuote qe perben 50% të kapitalit

Te cilet me vendimin e ortakeve Nr. 2, kane vendosur te transferojne kuotat qe zoterojne ne favor te Ilir Zyferi dhe nenshkrimin e kesaj kontrate nga Ergys Karina.

1. OBJEKTI

Objekti i kësaj kontrate është shitja e kuotave të zotëruara nga ortakët Irdi Karina dhe Ergys Karina dhe blerja e ketyre kuotave nga Z. Ilir Zyferi.

Shitësit nëpërmjet kësaj kontrate deklarojne se me vullnet të lirë dhe të plotë si dhe në bazë të legjislacionit në fuqi dëshirojnë që ti transferojë nëpërmjet shitjes, kuotat që ata zoterojnë në kete shoqëri në favor të bleresit i cili deklaron se është plotësisht dakort që te blejë këto kuota qe perbejne 100% te kapitalit te shoqërise.

2. ÇMIMI

Palët në marrëveshje të përbashkët kanë rënë dakort se çmimi i shitblerjes së kuotave që po transferohen nëpërmjet kësaj kontrate është në vlerën 500 000 (peseqind mije)Lekë.

Kjo vlere do te likujdohet nga pala blerëse në favor të palës shitëse nepermjet trasnferetes ne llogarine bankare te z. Irdi Karina dhe mandati perkates do ti lidhet kesaj kontrate.

3. DEKLARIME DHE GARANCI

Pala shitëse deklaron dhe garanton palën blerëse se është zotëruesi i ligjshëm i kapitalit që po transferon nëpërmjet shitjes sipas kësaj kontrate. Në rast të kundërt pala shitëse merr përsipër personalisht zgjidhjen e cdo lloj konflikti.

Në të njëjtën kohë, pala shitëse merr përsipër, garanton dhe siguron palën blerëse se sot në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate kuotat objekt – shitblerje:

- Jane te lira nga cdo barrë, marrëveshje apo vendim tjetër kufizues;
- Nuk janë objekt i ndonjë konflikti gjyqësor;
- Jane te lira nga çdo e drejtë apo pretendim i personave të tretë;

4. KALIMI I TË DREJTËS SË PRONËSISË

Pala shitëse deklaron nën përgjegjësinë e saj personale se me nënshkrimin e kësaj kontrate heq dorë nga të gjitha të drejtat që i takojnë per 100 % te kapitalit themeltar që po transferohet nëpërmjet kësaj kontrate dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet lidhur me 100% të kapitalit të shoqërisë objekt i kësaj kontrate i kalojnë blerësit i cili bëhet pronar i vetem.

5. PASOJAT E KALIMIT TË KUOTES

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate shoqëria "IRDI & ERGYS" Sh.p.k do të ketë nje ortak te vetem : Z. **Ilir Zyferi** zoterues i 100% te kapitalit te kesaj shoqërie.

Personi që kalon kuoten dhe ai që e fiton ate, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotes, nga Çasti i kalimit deri në Çastin e regjistrimit të kalimit sipas dispozitave në fuqi.

6. REGJISTRIMI I KONTRATËS

Kjo kontratë duhet të regjistrohet pranë QKB-së. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

7. SHPENZIME

Të gjitha shpenzimet që kanë lidhje me këtë kontratë do të paguhen nga pala blerëse. Palët në këtë kontratë nuk mund ti kërkojnë njëra tjetrës uljen/ngritjen e çmimit të shitjes për shkak të shpenzimeve të sipërpëmendura.

8. INTERPRETIMI I KONTRATËS



Çdo kusht apo formulim që mund të shkaktojë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët në lidhjen e kësaj kontrate.

Për çfarë nuk është parashikuar në këtë kontratë, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

9. NJOFTIMI ZYRTAR MIDIS PALËVE

Çdo njoftim, kërkesë apo komunikim ndërmje palëve do të bëhet në formë të shkruar dhe në adresat e përshkruara në këtë kontratë.

10. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi apo zbatimi i kushteve të kësaj kontrate, do të zgjidhet me bisedim dhe mirëkuptim të ndërsjellë midis palëve dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Nëse midis palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me bisedim dhe mirëkuptim, atëherë zgjidhja e mosmarrëveshjeve do të bëhet nga gjykata kompetente shqiptare.

11. HARTIMI I KONTRATËS



Kjo kontratë hartohet në bazë të kërkesës së të dyja palëve në katër njësi origjinale të cilat kanë të njëjtën përmbajtje dhe vlerë ligjore, prej të cilave nga një njësi e mbajnë palët, një njësi depozitohet pranë QKB-së dhe një njësi mbetet në arkivën e kësaj zyre noteriale.

Unë noterja, i lexova dhe i shpjegova përmbajtjen e kësaj kontrate Shitje Kuotash të dyja palëve.


Palët pasi më deklaruan se e kanë kuptuar dhe se e pranojnë këtë kontratë, pasi ajo është në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje në bazë të ligjit Nr. 110/2018 date 20/12/2018 "Per Noterinë".

PALET KONTRAKTUESE

SHITËSI

 Evadë Ruz
 Irda Karina

BLERËSI

ILIR ZYFERI


Notere
Marsela Veseli





REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-20191206144222274
Data e Rezultatit te Kerkimit: 06.12.2019
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 2:42:22PM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-561-571
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

IRDI & ERGYS SH.P.K.



Adisa Zoku

SHOQËRIA "IRDI & ERGYS" SH.P.K

VENDIM I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ORTAKEVE

Nr. 2 Datë 19/5 /2019

Sot, më datë 19/5 2019 në Selinë e Shoqërisë "Irdi & Ergys" Sh.p.k ishin prezent dy ortakët:

- Irdi Karina i cili zotëron 1 kuote qe perben 50% të kapitalit
- Ergys Karina i cili zotëron 1 kuote qe perben 50% të kapitalit

Mbledhja u hap në orën 10.00 dhe në përfundim, në mbështetje të neneve 81 e vijues të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe Statutit të Shoqërisë ortakët ,

V E N D O S E N:

1. Të tjetersohen kuotat e zoteruara nga dy ortakët ne favor te Ilir Zyferi.
2. Largimin e administratorit Irdi Karina dhe emerimi i administratorit te ri Ilir Zyferi per nje afat 5 vjeçar.
3. Nenshkrimi i kontrates se shitblerjes prane noterit nga ortaku Ergys Karina.
4. Regjistrimi i kontrates prane QKB dhe ndjekja e çdo procedure te nevojshme do te behet nga administratori i ri.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ORTAKET:

IRDI KARINA

Ergys Karina

